

VENDIM
Nr. 43, datë 22.1.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN I BLOKUT ‘LORD BAJRONI’– ‘RIZA
CUKA’–‘PANDI DARDHA’–‘DRITAN HOXHA’, BASHKIA TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban i bllokut ‘Lord Bajroni’–‘Riza Cuka’–‘Pandi Dardha’–‘Dritan Hoxha’, Bashkia Tiranë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 14 840 576 (katërmëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 14 840 576 (katërmëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN I BLLOKUT ‘LORD BAJRON’-‘RIZA CUKA’- ‘PANDI DARDHA’-‘DRITAN HOXHA’, BASHKIA TIRANË

NR. RENDOR	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë, etj)
													"TRUALL"			VLERA TOTALE (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale m ²	Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
1	Leila Mufit Seres Mimoza Odin Erval Silven Kemal Andon Behire Shasha Enver	Shefqet Elmaz Rifat Servet Servet Elmaz Pal	Libohova Libohova Turku Libohova Libohova Libohova Libohova Mirashu Libohova Libohova Libohova	Tiranë	8310	8/405	Truall	169.00	169.00	0.00	20	188	104.20	31,219	3,253,020	3,253,020	
2	Behire Enver Erval Kemal Mimoza Odin Saide Seres Shasha Mufit Leila	Elmaz Elmaz Shefqet	Libohova Libohova Libohova Libohova Libohova Mirashu Turku Libohova Libohova Libohova	Tiranë	8310	8/404	Truall	674.40	674.40	0.00	20	187	230.90	31,219	7,208,467	7,208,467	
3	Zenel Dritan Adrian Ervin	Abdi Zenel Zenel Zenel	Rami Rami Rami Rami	TIRANË	8310	8/1063	Truall	500.00	500.00	127.20	70	141	95.63	31,219	2,985,473	2,985,473	
4	Skender	Sinan	Lusha	Tiranë	8310	8/1042	Truall	221.00	221.00	63.20	62	161	36.33	31,219	1,134,186	1,134,186	
5	Agim Aida Arjan Bukuric Elma Eva Fiqirete Fitnet Gert Lindita Manjola Mimoza Mirvjeta Rebecka Rozana Sulejman Vjollca Xheladin	Enis Fatos	Irfan Qemal Qemal Irfan Bajram Bajram Petric Zeqir Haxhi Xhelo Tamburi Petric Shefqet Selim Selim Shefqet Selim Irfan Irfan Zeqir Beqir Qemal	Pustina Kurani Gjeli Shkupi Mati Gjeli Gjeli Shemsu Gjeli Tamburi Gjeli Dashi Gjeli Isaj Gjeli Dollani Pustina Shemsu Gjeli Gjeli	Tiranë	8310	8/367	Truall	200	200	0	11	103	8.31	31,219	259,430	259,430
VLERA TOTALE													475.37			14,840,576	